



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:178008

Datë: 14.08.2024

Numri i dokumentit: 06051741

C.nr.144/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH - CIVIL_DEPARTMENT, si gjykatë civile e shkallës së parë, nga gjyqtarja Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), Bulevardi Bill Kllinton, Nr.5, Ndërtesa e Elektrokosovës, Kati II, Nr. 5 Prishtinë, 10000, të cilën e përfaqëson V. C. me autorizim, kundër të paditurit S. (F.) R. nga fsh..., Komuna e Dragashit, për kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 448.35 €, jashtë shqyrtimit me dt. 14.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-

I. REFUZOHET si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a., Bulevardi Bill Kllinton , Nr.5, Ndërtesa e Elektrokosovës, Kati II, Nr. 5 Prishtinë, 10000, të cilën e përfaqëson V. C. me autorizim, kundër të paditurit S. (F.) R. nga fsh..., Komuna e Dragashit, me të cilën ka kërkuar që të: Detyrohet i padituri që paditësës të ia paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej 448.35 Euro dhe atë me kamat ligjore duke filluar prej datës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës së këtij kontesti – të gjitha në afat prej 15 ditësh me kërcënimin e përmbarimit”.

II. Secila palë i mbanë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj me datë 04.08.2021 ka parashtruar padi për kompensim të demit material kundër të paditurit S. R. nga fshati..., Komuna e Dragashit.

Në padi paditësja ka theksuar se sipas Aktgjykimit penal të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Dragash 2018:049.. të dt. 10.09.2018 këtu i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje nga neni 314 lidhur me par. 1 dhe 6 të KPRK-së, kurse e dëmtuara tani paditësja është udhëzuar në kontest civil për kompensimin e dëmit të shkaktuar në lidhje me veprën penale të lartpërmendur. Me veprimin e tij i padituri i ka shkaktuar paditësës dëmin material në vlerën prej 719.66 euro mirëpo ka bërë pagesën prej 270.81 euro dhe se mbetja e këtij dëmi është 448.35 euro.

I autorizuari i paditëses me parashtrseën Nr.747 të dt. 25.07.2024 e ka njoftuar gjykatën për heqje dorë nga padia dhe kërkesëpapia në lidhje me çështjen objekt kontesti, duke arsyetuar se i padituri me datë 19.07.2023 e ka paguar borxhin në shumën prej 400 euro dhe në këto rrethana del se i padituri i ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj KEDS sh.a., sa i përket kthimit të humbjeve.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpapia nga ana e paditëses, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpapia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”* – pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në lidhje me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi që secila palë të mbaj shpenzimet e veta procedurale e këtë duke u mbështetur në nenin 450 dhe 452 par. 4 të LPK-së.

Nga të lartëcekurat dhe bazuar në nenin 149 par. 1 të LPK-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:178008, 14.08.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kunder këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 dite, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nepërmjet kësaj gjykate. Në kuptim të nenit 181 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpapia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.